# DËSHMI ARKIVI

**A-440491**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Zëdhënësi i Aleancës akuzon VV-në për votimin e Vujoviqit: U dorëzuan para agjendës së Listës Serbe |
| ADRESA | `https://tpz.al/zedhenesi-i-aleances-akuzon-vv-ne-per-votimin-e-vujoviqit-u-dorezuan-para-agjendes-se-listes-serbe-i332805` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 18:52:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 10:17:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2785a675f58a843959b47541f3f230df4a061a57bfd33f3cd7a418fc6f3f0811` |
| TEKSTI | `4cb4482fb24ca834001344c54436b639f7ce71f2b16f008da72fdc43d4463b0a` |
| PAMJA | `e824f783fccf3c0790824da398e2081624f1956b41f03051ac74993998d3af1e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7fe9b215f523067161458de5520d4e76f8a26c90fdfffb21adf62b202bea6050` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7fe9b215f523067161458de5520d4e76f8a26c90fdfffb21adf62b202bea6050`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BALLKAN, 13 SEPTEMBER 2026, 12:17

# Zëdhënësi i Aleancës akuzon VV-në për votimin e Vujoviqit: U dorëzuan para agjendës së Listës Serbe

TPZ




Zëdhënësi i Aleancës, Kushtrim Xhemaili, ka reaguar pas votimit të Tanja Vujoviqit, nga Lista Serbe për nënkryetare të Kuvendit të Kosovës, duke e cilësuar këtë veprim si "kulmin e hipokrizisë dhe populizmit" të pushtetit.

Xhemaili ka thënë se, pas refuzimit të disa emrave në votimet e mëhershme, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje në fund votuan për Vujoviqin.

"Asgjë, bash hiç asgjë nuk e dallon Tanja Vujoviqin nga Sllavko Simiqi. Që të dy janë nën të njëjtën komandë direkte të Beogradit dhe që të dy kanë mision sabotimin e shtetësisë së Kosovës", ka deklaruar Xhemaili.

Sipas tij, deklaratat publike të Vujoviqit dëshmojnë qëndrimet e saj ndaj institucioneve të Kosovës.

"Çdokush që kërkon në internet mund t'i gjejë deklaratat skandaloze të Vujoviqit, e cila hapur e quan Kosovën 'Metohi', deklaron se punon vetëm për sistemin e Serbisë dhe e krahason situatën në veri me 'sundimin osman'", ka shkruar ai.

Xhemaili ka bërë edhe një krahasim mes Vujoviqit dhe Simiqit, duke thënë se dallimi mes tyre qëndron vetëm në mënyrën se si, sipas tij, i kanë kundërshtuar institucionet e Kosovës.

"Dallimi i vetëm është se Simiqi i ka luftuar institucionet tona brenda Kuvendit, ndërsa Vujoviq, si dekane e strukturave ilegale, i ka luftuar ato fuqishëm edhe nga jashtë, publikisht madje", ka thënë ai.

Zëdhënësi i Aleancës e ka akuzuar Vetëvendosjen se votimi i sotëm dëshmon mungesë të parimeve dhe vijave të kuqe politike.

"Ata i rrëzuan emrat e parë vetëm për t'u shitur 'patriotizëm' militantëve në rrjete sociale, përpara se të dorëzoheshin për të votuar saktësisht të njëjtën agjendë të Listës Serbe", ka deklaruar Xhemaili.

ide!

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?
Nga Thoma Gëllçi

"Liria punon", por duhen edhe 6 milionë dollarë!
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

Në fund, ai ka përsëritur qëndrimin e Aleancës se zhvillimet në Kuvend janë pjesë e një "teatri të koordinuar" mes pushtetit dhe Listës Serbe.

"Aleanca e ka thënë qysh herët, ky teatër i koordinuar mes pushtetit dhe Listës Serbe është një maskaradë e pastër që po e mban peng dinjitetin e Republikës!", ka përfunduar Xhemaili.


BALLKAN / 13 September 2026, 11:22

## Konstituohet Kuvendi i Kosovës, pas bojkotit të PDK-së, votohet një kandidate e Listës Serbe si nënkryetare

BALLKAN / 13 September 2026, 10:57

## Kujtim Shala i LDK-së zgjidhet nënkryetar i Kuvendit të Kosovës me 75 vota

BALLKAN / 13 September 2026, 10:20

## PDK pezullon kandidaturën e Çitakut për nënkryetare të Kuvendit të Kosovës: Nuk do të marrim pjesë në seanca, fjalën tani duhet ta thotë Kushtetuesja

BALLKAN / 12 September 2026, 22:53

## Kriza politike në Kosovë/ Vetëvendosja: Nesër mblidhet seanca konstituive, do të votojmë Vlora Çitakun dhe Kujtim Shalën për nënkryetarë të Kuvendit

BALLKAN / 12 September 2026, 21:06

## Vdekja e Mazonakis/ Ngrihet alarmi nga mjekët, thirrje qytetarëve: Kujdes me terapitë alternative, informohuni për trajtimet që merrni

BALLKAN / 12 September 2026, 20:40

## "Marshi për Liri" në vëmendjen e mediave botërore

BALLKAN / 12 September 2026, 18:20

## Eliza Hoxha: "Marshi për Liri" u organizua edhe më 1999, e ne sot marshojmë në liri për liri

BALLKAN / 12 September 2026, 17:37

## Vjosa Osmani zbulon planet pas Presidencës: A do të rikthehet në garën për kryeministre?

BALLKAN / 12 September 2026, 15:00

## Fjalimi prekës në Prishtinë, vajza e dëshmorit: U rrita me mungesën e babait dhe xhaxhait, por me krenarinë për familjen time

BALLKAN / 12 September 2026, 14:45

## "S'ka qetësi nëse vendimi sjell padrejtësi"/ Mesazhet e qytetarëve përmes pankartave në Kosovë: Kur preket UÇK-ja, ngrihemi të gjithë

BALLKAN / 12 September 2026, 14:27

## Pritet të shpallet më 16 shtator, BE kërkon respektimin e vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për Thaçin dhe 3 ish-krerët e UÇK-së

BALLKAN / 12 September 2026, 13:24

## Aktgjykimi për Thaçin dhe të tjerët/ BE: Të gjitha palët të respektojnë vendimin e Speciales

BALLKAN / 12 September 2026, 10:25

## "Marshi për Liri"/ Sot në Prishtinë, mbështetje për ish-krerët e UÇK-së para vendimit nga Haga

BALLKAN / 11 September 2026, 20:14

## Detaje tronditëse nga vdekja e papritur e Mazonakis/ Pasi pësoi arrest kardiak, mjekët kërkuan në ChatGPT si ta rikthenin në jetë, ndërsa një foto e këngëtarit ishte fshirë

BALLKAN / 11 September 2026, 18:34

## Kriza politike në Kosovë, Kurti i bën sërish thirrje Hamzës për takim: PDK-së i duhet vota jonë për nënkryetarin, neve për Presidentin

BALLKAN / 11 September 2026, 15:57

## Kuvendi i Kosovës rifillon punimet, por PDK-ja nuk kthehet në sallë/ Haxhiu: Hajdeni të vazhdojmë punën

BALLKAN / 11 September 2026, 14:02

## Dyshohet se mori 17.500 euro ryshfet, arrestohet ndihmësdrejtori i Doganave në Maqedoninë e Veriut

BALLKAN / 11 September 2026, 12:39

## 'Rrëzohet' Vlora Çitaku/ Deputetët e Kosovës dështojnë sërish! Nuk konsituohet Kuvendi, PDK braktis sallën, Haxhiu ndërpret seancën

BALLKAN / 10 September 2026, 22:23

## Gazeta gjermane FAZ: Durimit të BE-së me Serbinë i erdhi fundi, Vuçiçi nuk duhet të tolerohet më

BALLKAN / 10 September 2026, 16:05

## Gjyqi në Hagë, Prokuroria kërkon dënim me 6 vjet burgim për Thaçin, zbardhet akuza

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.